



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.552/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e Arben Shalës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat ZL.A.nr.552/2017 dhe ZL.A.nr.557/2017, të datës 30.10.2017 të parashtruara nga Arben Shala, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, të paraqitura për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.552/2017 dhe ZL.A.nr.557/2017, të datës 30.10.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL Anr. 552/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 30.10.2017, PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa nga Arben Shala, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren në të cilën kanë theksuar se:

Ankesa ZL Anr.552/2017, pretendon se kandidati për asamble komunale në Prizren nga subjekti politik PDK Avni Hajdari me nr. 38 në QV në fshatin Hoqë e qytetit i janë keqpërdorur votat duke ja numëruar ndonjë kandidati tjetër. Parashtruesi i ankesës thekson se i njëjti rast ka ndodhur edhe në QV në fshatin Billushe, Atmaxhe dhe në QV-në shkollën “Fatmir Berisha”.

Ankesa ZL Anr.557/2017, pretendon se në fshatin Mushnikov në vendvotimin 01R/2011 ka ndodhur një parregullsi në lidhje me plotësimin e formularit nga kryesuesi i LVV-së, pasi që është bërë gabim teknik në plotësimin e kutive të formularit tek partitë politike ku tek PDK është lëvizur numri i votave dhe se në vend që të shënohet 79, është vendosur 0 (zero) për PDK-në.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.552/2017 më datën 31.10.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*